

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-1

Sh 65

Azem Shkreli

poezi




814-1
5665

AZEM SHKRELI

LOTËT E MALEVE

Poezi nga Kosova

29610



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

BALLADA NË GUR

Te kroni i Cërnalevës

Ë kemi nda përgjysë zemrën e kësaj Bjeshke dhe
më të
dashninë e mallin e masim çdo mbramje e në çdo
agim;
tokë e shkamb jemi ba me mbrojtë tokën e shkambin
tonë:
kangën e djepit, krenin' e vashës e sofrën e gëzimit
për mik
dhe ksulën e qiellit mbi votër-tapinë, tapinë e gjyshit
jetik.

N'cilën parzëm nane, oj tokë,
verbue për rrezet e ballit,
n'cilat gërmadha të plangut fikun

krojet e lotit me t'i gjetë,
krojet e malit —
tokë e shkretnueme!

— Cërnalevë, oj nanë, pse vjen kaq vajë?
— N'zemër mâ n'gjitë kolona e idhët si rrshajë!

LULE GJAKU

*(Dymbëdhjetë dëshmorëve të rij, ra në Lipovicë, në
vjetin 1943)*

1.

Nji çetë djelmosha nxori prej gjini at'natë
Kosova kreshnike — agimit ja fali dhuratë.

2.

Dymbëdhetë kapela n'terr u përzien si hije,
dymbëdhetë kapela — mall dhe shej krenie.

3.

U nis kolona n'udhën e kuqe t'lirisë,
n'udhën e shejtë, me hovin e ndezun t'rinisë.

4.

Disa as fjolla s'kanë ende n'për f'tyrë,
as sy ndër sy me vasha ende s' janë kqyrë.

5.

Qetsi. N'për zemër nate kolona hapin s'e ndal,
me vrullin e gjakut që zien e vlon si valë. . .

6.

Za as zog kurrkund në natën e zezë;
n'për udhë të padija një shpresë dritat i ndez.

7.

Ecim. Agimi shkrep me reze ndër bajoneta
dhe n'log beteje me vdekjen ndeshet jeta.

8.

Blerimin n'sy e kanë, po asnji s'trembet
kur dijnë se vendi thundrës s'huej po u shembet.

9.

Ofshani mali n'kob' dhe ndër vetima,
me gjak të ngrohtë rinie u skuq ledina.

10.

N'sytë e secilt flamur' i kuq valon,
n'sytë e secilit kah mordja me radhë pikon.

11.

Tash rriten nëpër stinë — kreni dhe mall,
me gurë kujtimi n'zemër, me lule gjaku n'ballë.

KANGA MBI MURANË

I puthi pranvera
stinët e thame n'gurë,
bekimi i fundit i nanës!

Edhe gazmendi
u fik me lotin e mallit,
betimi i shtrejtë i motrës!

Edhe dashnia
flakë u dogj në zemër,
kanga e thyeme e vashës!

I puthi pranvera
Stinët e thame n'gurë,
lulja e kuqe e agimit!

PËRSHËNETJA

Lahuta e vjetër n'tra ka zanë m'u kotë
dhe kanga e gjakut n'sharki.
E, dalë kularit qetë/ shih,
duen me i shkye ledinat.
Ndër ara buke t'bërlyket
tash një dem me rrotë,
një dem me hekur n'bri...

E ngrite kokën sot me matë me sy
sirenën sa hataja.
Dhe ja, ku t'ra
qeleshja e lashtë n'tallë...
Shiko, nalt, te dielli,
Dukagjinat, vlla!
Me fat — se t'paska hije
tufa e rrezeve n'ballë!

KRENARIA

Larg ndër thepa sot shikimi m'iku
mbi dredha t'Drinit, tue këputë kopshtije e
fusha;
me rreze majë krahnorin jetë e mbusha
dhe ndjeva se si n'mendje fill m'piku
trolli im shkambor:

lugjet bleroshe, tufat kokrrue n'shullaje,
n'për logje stinësh u ktheva ndër dit'fëminie,
nisa me bredhë nëpër çdo shtek e hije;
bjeshkën, malin e pashë, e nalt ndër maje
do cukla borë,

dhe vashat syshkrueme, bijat e fshatit tim,
malsorin shkamb e djerrinat gratçore,
rrapin me gurë, çdo skutë e çdo bregore,
e m'tha 'i kreni, përzie me mall e g'zim:
Tek jam ende malsor!

TAKIMI

N'për gjurmë fëminie, sot, ja ku m'solli udha
te «vorr' i Ymerit» n'Lugje. Ende zbardhueka tuba
jote,
Shpend! Na moti, cok, s'jem' pa — dhe sa shumë
rrudha
t'paskan dhurue këto mote!..

I mbështete n'krryle shtatëdhjetë vjet pleqnie.
S'po m'njef? E vune dorën n'ballë, se syt' po
t'rrjellojnë pak.
Mendove: I dhenash t'hueja... Mos dikush prej
«paric».
t'thot': — Tunjatjeta, plak!..

Nën rreze gushti balli t'shkëlqen si pllaja
përgimun shikimin e turbullt kah e derdh.

Po a din sa herë kokrrojshe tubat n'ograj
me 'i far' vocrraku flokverdhë?!

Eh! Kurr' mallëngjimi buzën s'ta dridhi si sot
tue m'përshëndetë kur t'thash' unë — lamtumirë!
E m'përqafove — pikun zemrës nji lot
dikoi e u vodh n'për mollza, me pahirë.

Kujtove ditët e njoma, harrue si himna,
me moca kur shkurtove pipat n'kamb' e n'dorë.
Tash vjeshta vjen. Ti s'din edhe sa dimna
t'i hjedhin mustakut borë!..

N'për gjurmë fëminie, sot, ja ku m'solli udha
te «Vorr' të Ymerit» n'Lugje. Ende zbardhueka
tuba jote,
Shpend! Na moti, cok, s'jem' pa — dhe sa shumë
rrudha
t'paskan dhurue këto mote!..

MALËSORJA

Majës po zbret një re murroshe me rrëke,
(thue shi do t'bjerrë a breshën!)
ka me zanë bareshën
n'pallajë, te currat, kah rritet me kope.

A' n'fushë malsorja. Herka s'ja mba' pikën.
Drue kanga n'buzë i këputet.
Nuk ka kur futet.
Dashnin' shtërngatat n'zemër kur' s'ja fikën.

«Zana i raftë! — mallkimi n'fund t'shpiritit
hesht —

N'pishë dielli ç'na u desht ky shi?»
Ja lagu letrën n'gji.
at' letër malli që shkroi n'do çufrra n'kreshtë.

Po qe «ai shejtani»: n'curr hyp: ban me dorë.
S'din se me i tretë bagëtia.

ajo s'ka ku te shpija.
E vetet ftyra. E bahet fisi horë...

Oj motër, fis e kanu — urtitë që mësuem si fëmi,
harroji, tash janë punë prrallash!
Unë n'log gjinkallash
tue lotue fatin, kurr' ma s'due me t'ndi'!

KANGË ARKAIKE

Vendlindjes

Kur këndoj për ty — a mundem me matë vargun,
vrullin e kangës me thye?
Le të m'quejnë me njiqind emna, le të m'thonë
poet i çmendun!

Kur këndoj për ty — a mundem me mshefë mallin,
mallin e stinëve që s'kthehen?
Le ta përqeshin kangën time ma t'bukur, le ta
quejnë
kangë arkaike!

Kur këndoj për ty — a mundem me shfre gëzimin,
dallgën e ditëve djaloshare?
Le t'i lidhin nye këto fiye vargu, le t'i varin
kritikët n'qafë!

Kur këndoj për ty — a mundem me shue
dhimbjen,
lotin për fminin' e tretun?
Le t'ma harrojnë emnin e vorrin, le t'më njofin
vetëm gjinkallat!

Kur këndoj për ty — a mundem me matë dashninë,
dashninë e gurit për gur?

KANGA E KUQE

N'ballë t'Afrikës vetoi,
e kishte Afrikën n'ballë.

N'gjakun e Kongos u dejë,
e kishte Kongon n'gjak.

N'zemër t'Afrikës e vranë,
e kishte Afrikën n'zemër...



29610

NË BUZE TË REKTIMIT

E para porosi

Gjyshi yt plaku e ka ba vendin mur
në themelet e një piramide,
tue ndërtue shtëpi për zotën e për dreqën.
Lëkurën e përbuzun t'zezakut ernat ja kanë lënurë
diku, në majë të një kështjelle
të dhimbjeve tona.

Kur t'rritesh,
voglushi im i dashtun!
kurr' mos ua shtrij duert e lypës, duert e dhimbjes
madhnive t'fjetuna n'qiell!

E dyta porosi

Të ka vdekë nanëzeza
me duert t'kryqzue me n'votër,

tue kujtue një ninulë lumnie për birin e vetëm,
e asht shndërrue në bekimin e mbramë:
që kurr' mos ta ndiejë vajin e lodhun, roshkun
e djegun
te krojet e thata t'gjinit.

Kur t'rritesh,
rrita e namun e këtij trolli,
kurr' mos e pështyj gjinin e nanës, dhantin' e saj
për emnin që ta fali!

E treta porosi

Edhe unë ta mbolla hijen e krrusun
te praku i çdo të bardhi dhe në plagët e zeza të
kësaj toke,
në kandarin e lashtë të së cilës — një jetë e jona
ende s'peshon as një gram ari për t'huej;
këtu gjakun e djersën e lotin prore i kam shitë
pa pare
për një trohëz buke edhe njëmijë të shame
farës e fisit dhe gurit të vorrit tim.

Kur t'rritesh,
lindja e pagëzueme e kësaj dite,

kurr' mos e shkel vorrin e babës, hijen e shkelun,
për ngjyrën e lëkurës sate!

E mbramja porosi

Sot edhe shtëpinë ma dogjën,
shtëpinë e lindjes;
sot edhe gjakun ma pinë,
gjakun e papaguem;
sot edhe sytë m'i puthën
me katër bajoneta,
voglushi im i dashtun!

Kur t'rritesh.

mblidhi eshtnat tanë gjithkah shkromanave tona,
eshtnat tanë e t'etënve, klithjet e dhimbjeve tona,
dhe ngrehe një piramidë prej rrashtash deri te
reja:
përmbi Keopsin, në maje t'shekullit ngjitu.

URAGANI

Uragani
në flokët e shprishuna t'vashave,
uragani
në gjethet e palmave t'përgjakuna.

— Saharë!
Kemi me të mbjellë me rrashtat tona,
fara ma e lirë dhe ma e shtrejtë e kësaj toke!

Uragani
n'kangën e thyeme t'luftëtarëve,
uragani,
xhungla po dridhet nën kambë.

Saharë!
Kemi me të nojmë me gjakun tonë,
vena ma e lirë dhe ma e shtrejtë e këtij trolli!

Uragani
n'ofshën e dhimbjes së nanave.
Uragani
n'flatrat e flamurit t'rreckosun.

DITIRAMB

Kemi me u zgjue edhe na të vdekunit
në darsmën e kuqe të kësaj toke.

Mos na i harroni emnat,
mos na i harroni vorret.

Me duert e thyeme tonat kemi me shkrue
hinnin e shekujve n'qiell.

E do të kallen zamaret e gjakut,
do t'kallen tarabukat e gëzimit.

Kemi me u zgjue edhe na të vdekunit
në darsmën e kuqe të kësaj toke.

Mos na i harroni vorret,
mos na i harroni emnat...

D A L L G A

Po i thejmë gotat e shikimeve flakë,
po dehemi.

Po i këpusim tana lulet e majit,
po i thurim kunorë.

Po i lidhim fjalët e këqija, prozhmimet,
po ja falim erës.

Po i lëshojmë langojt' e çmendun t'gjakimit,
Le të trenohen.

Po bahemi mëkat-mëkatën po ua lamë
fetarëve me mjekrra.

Në daç po i qethim edhe rrezet,
po i bajmë fjongo kujtimi.

Po i thejmë gotat e shikimeve flakë,
po dehemi!

MARGARITA

N'shullaje gazmendi, a thue
rreze dyshimi pse shkrep,
Margarita?

E dhimbjen për ty e ndryna me heshtjen
n'zemër;
e dhimbjen për ty ja besova fjalës pathanun,
gjethit e zogut ja besova ja besova dhembjen
për ty!

N'kunorat e gjelbrimeve tona
lulet e buzqeshjes pse u thanë,
Margarita?

E mallin për ty e shkela rrugëve t'qytetit;
e mallin për ty e treta bulevardeve t'fjetuna,
flakë n'zemër e dogja mallin për ty!

Dallgë e thyeme ndër dallgë, Margarita!
Gëzim i fikun ndër gëzime, Margarita!

NË RRUGË

Tash jam diku larg teje, larg vedi
dhe — ku me dijtë kah më tresin
udhëkryqet e shumta t'jetës?

Jam ba përshëndetje e harrueme e
kalimtarëve;
jam ba lot e kangë;
jam ba betim i rrugëve dhe rreze e shkrepun
majë gurit.

Tash jam diku larg teje, larg vedi
dhe — ku me dijtë ku sosin
fijet e këputuna t'kësaj kange?

Jam ba pre shitimi i syve zjarr;
jam ba bekim e namë;

jam ba zog e re n'krah t'agsholeve t'bardha.

Tash jam diku larg tjeje, larg vedi
Dhe — ku me dijtë kah m'tresin
udhëkryqet e shumta t'jetës?!

POEMA E PAKRYEME

(fragment)

N'dritare t'kohës po vrej me sy lakmie
karvanin e stinëve si shpejt thek parzmave tona
kah shkojnë e vijnë breznitë si kallijt' n'ara.

Dreka e shekullit agon,
n'kupena tundet kumbona. . .

Hej, sikur t'lulonte mosha, (dëshirat e mia
t'marra!),
hovshëm do t'nxitojsha dikur logut t'moshës
s'kthyeme
dhe tana stinët e kangët ja kishem falë

SË NESËRMES SË MADHE,
— poemës sime t'pakryeme.

VALLJA E SHKREPAVE

Dora — dorës ngrehin kokën n're;
faqeve rrëpijat u ulen;
kur rreshkon dielli as kur tufani s'më'
ata s'përkulen.

Kang' as fyelli atje njiher' nuk ndalet;
grrellave prrojet lëshohen;
bisha t'unta atje gjesdisin malet
e rrallë takohen.

Verës me grigje plot i mbushin gjijt'
ditët e majit kur sosin
e sukë m'sukë thirren ndër vendi barijt':
— O! A po t'kullosin?!..

Lugjet me hije njomen e drujt' n'çdo ven'
rriten e lëshojnë freski;
ndër maje t'epura bora borën e zen
shum' herë pa u shkri.

Sa herë ju shof, o shkrepa t'vendit tim,
të ngjitun varg si n'valle,
m'përtrihet jeta e n'zemër m'guf nji gzim,
që shkel krajata e halle!

G R Y K A

Ndër vithe t'saj
janë thye dhëmballët e kohëve.

Bistrica e llastueme
ja lëpin damarët e akullt
dhe rend
me kangë t'gurgllimit ndër buzë.

Bistrica ngutet
Drinin ndër fusha m'e zanë.

Shpellat e shtërrbueme
hapin gojën n'shkamb:

«E msheft' asht prralla jonë,
shtegtar.

Ec, mos u shtang!»

Nalt,
ndër thika t'shkrepave
përgjaken retë...

H A J L A

Në kujtim të fëminisë sime.

Me kangë e vaj ndër buzë, si i malit fëmija
me thembra zbatë — sa shumë t'kam shkelë
n'për brigje
me lot e kangë tue t'mbytnun shpate e shtigje
o i bukur log e hije e stinëve t'mija!

Tash tha ndër mollza tretet vazhda e lotit,
përherë, kur nusja e stinëve ven kunorën,
kur diell pranvere rrëzon të tuat maje
e t'puth gjelbrimi, e bari guf n'lugoje
dhe tinguj fyelli derdhen n'ata shkrep
si dhambë jetikë, që bre i kan' rrmujt e motit.

T'kërkon ty mendja, t'fton plot hir pran'vedi
dhe zjen ndër dej ai gjaku i moshës s'shkueme
që ndër sa vujejtje gjen ndoj dit' t'lumnueme,

e n'perde t'kohës stin't me radhë valëviten,
e n'rrpije t'thikta epsheet me "i her' ngjiten —
n'sa zemra shtyn n'krahnor me 'i valë tërmeti. . .

Shtegtare t'lodhun t'shof atherë nën borë,
me t'akullt barrë mbi shpinë e vetlla t'ngrieme.
Veç larg n'ndoj skutë, a thellë n'për kreshta

t'thime

gjëmon si n't' rrallë një çifte, ndoj gjurmë lot,
pse i egër moti, e ftoftë asht nadja sot
kur shllunga ret' mbi krye t'janë zvarë, kunorë!

Tash dielli kandshëm nxe' . . . E n'dit t'qershorit
mue m'kanda t'shof, si din ti atherë me qeshë
dhe me u stolisë, si nusja kur t'jetë veshë
me u k'thye gjinije e t'shojt me i dalë përpara.
Atëhere je dë, ti Hajlë; veç n'bjeshkë do lara
si kësula duken — n'tepe t'kres malsorit. . .

Dhe qe, si thekshëm n'sukë fokrron kumbona,
si tufa tufën ndjek — kokrrue n'mallim
dhe si n'gjuhë t'vendoj dele thërret n'blegërim
përvajshëm qingjin, se n'bjeshkë janë 'da sot

shtërija,

e kanga vlon dhe vallja, vlon gjallnija,
si ushtin mali e lugjet merr lehona! . . .

*

Do t'denden stinët n'për ty, po stinët kurr ma
njomsin ndër flatra kurrkuj' s'ja kan' kthye
e përgjith vjet pranverat kanë me më gënjue —
por do t'kujtoj me lugje t'blerta e proje
dhe gjithshka' u rrita: gurë dhe suka e troje
— e shkambi zemër e zemra shkamb u ba.

Dhe kam me u thi, o Hajlë por n'ata thepa
dëshirë do t'kem unë përher' me i kërrmzue
ato kangë t'hershme që m'i ke pasë mësue —
sa herë zinxhir't rreth moshës t'm'i sjell' jeta!

K O S T A R Ë T

Me vi t'agimit vringllue kan' kosat rranzë gardhit,
dielli ndër maje tue le;
malsorët me shalla zbardhuen sot n'krye t' livadhit
e janë tu' pre;

e dredhojnë shtatin e kosat, të mprefta si halë,
zhyten si njala n'për barë,
rroken e nguten, secili përpara do t'dalë
ma i miri kostar;

me njeni-tjetrin dredhin mandej tue u tallë
kur n'fund t'ledinës t'kenë sosë,
n'sa 'i plak i mbetun mbrapa, tue sjellë ma rrallë
nis' e ankohet në kosë;

e bajnë do lodër e mandej, si ma parë,
plakun e vënë përpara,

mbas tij vargohen mandej si ushtarë,
si e lyp e mbara.

Dhe hapen shpatllat e kosat të mbrefta si halë,
zhyten si shlliga n'për barë.
Kosat fishkëllojnë, e jehu i kangës merr malë.
— O, krah't ju lumshin, kostarë!

Qe, buzës malit malsorja me tepsi n'krye
leqe m'leqe tash ngjitet:
piten e sjell, të rreshkun mirë e lye
që mos t'koritet...

L A K M I A

N'livadh ka ndritë sot heret nusja belhollë
e shtatin dredhon si zanë;
buzët të ngjyeme e i ka e faqet kuq si mollë,
si rrethi i s'bukurës hanë.

Nji erë e lehtë, që ditën kodrave bredh,
fryn e faqet ja lëmon
dhe flokun n'ballë e fustanin ja hjedh,
që shpat m'shpat zbardhon:

— O, mori e mirë që po mbledh sanë! —
gufon diku sevdaje;

— O, krejt livadhin, moj, ma ke nxanë!..
E jehu tret ndër maje.

— O, goja t'lumtë, kangtar atje n'rudinë,
por nusja e ka një djalë
që syni vet' ja zgjodh e bukurinë
atij vet' ja ka falë!.. —

RRËFIMI I GJYSHES

«Kan' qenë një vashë e 'i djalë
e djali n'vashën a' tekë;
kan' ra të dy në një fjalë
e t'dy n'dashni jan' pjekë»

— M'pat thanë gjyshja njëherë
n'sa m'fliste për dashni.

«Po' n'kanu' t'maleve tona
e egër vjen dashnia.
O bir, kur t'rritesh, rueju,
se hieja e saj n'k'to ana
ka fikë sa troje e shpia».

— Ofshani thellë at'herë
e foli plot urti:

«I krisi pushka djalit një ditë të shpia,
e la shakull mbi prak;
ndër dhena t'hueja edhe vashën e treti duhia
e fatit të lamë me gjak»

— Tha plaka, e' i hije zie,
si reja, i ra mbi sy.

«Kan' qenë, po, vashë e djalë,
e vasha n'djalin a'tek,
kan' ra të dy n'nji fjalë,
po t'dy n'dashni janë djegë.»

— E zemra e mbushun vnerë
rënkoi një herë me mëni:

«... Ka ndodhë, por kjo ka mot»
— tha gjyshja kokën varë,
tue namë kanunin plak,
që n'shekujt s'bani lak,
dhe i rrodhën fill do lot...

Tash m'dhimbset gjyshja e mjerë
që vdiq me kanu' n'gji...

M A L L I

«Rrok at fyell, o bir, e ditët kujtomi
që n'këto shullaje rritë m'kan' e rreshkë,
— iu lut plaku t'birin malsor në bjeshkë —

T'prenduemet andrra zgjomi
që barra e vjetve m'shoi!»

Larg, ndër maja i tretun shikimi ngau
kur fyelli ra e mbushi lugjet tinguj plot,
ndër gropza syt' e lëbyrtë u mbushën lot.

Por plaku mbrenda qau
e lodja nuk pikoi.

«O m'thuej, lum baba, sot ç'kujtim t'përloti
që n'çaste t'liga kurr ma keq s'tkam pa:
Loti yt po m'djeg sa m'ban me qa!»
— E ai, rroshkue mallit, fyellin n'buzë e bjen

e don me i fry si moti,
po fryma i shkonte huq.

«N'at vetull mali, shif, atje nën pllajë
fyelli im dikur ndihej n'shtat maje;
plaka, jot amë, pat ikë e, çmendë sevdaje,
m'hyni n'shpi, e tash kam katër djem»

Dhe fill një vashë n'fierajë
u duk, e djali u skuq...

KALLXIMI NË TRI KANGË

SHPUTAT E HUEJA

Ndër tana shoqet vet' ma e vogla ishte
kur ruente delet, dikur;
faqet e njoma e sytë si rrush i kishte,
i ndriste f'tyra si nur.

E gjeta njiherë vetëm, ulë nën lis,
ku prore mrizonte gjanë:
— Zade moj, shputat ti heret i paske nisë!
E skuqun, tha: «T'huejat janë...»

MOHIMI

... Habitshëm, vithet e plota me sy ja mati
baba vajzës nji ditë:

— Grue moj, Zadja asht rritë e miku gati,
nuk thot' e mira me pritë!..

— ...S'e due, tha vajza, — e n'f'tyrë i hypi
gjaku,

turpshëm t'jatin tue kqyrë.

Me gjaca n'sy, por egër u shqirr plaku:

— Hesht! Se s'luejmë na me fëtyrë!

TUFA E TRETUN

Asht vonë, dhe burrë e grue dalin me fnerë
e thërrasin qetë m'qetë;
posht' e nalt e lypin bareshën e mjerë
e thonë: Ç'e ligë e gjet'?!

— O, ktheni, t'dashtun, ktheni t'qetë dhe flinë
e kot mos bridhni ju malit,
se Zadja tash asht larg dhe kërkend s'ndien
pos t'puthunave t'ngrohta t'djalit!

A K U A R E L E

MBRAMJA

Prej malesh del e zbret ngadalë errsina,
msheftas lugjava bredh
përmbi pullaze, dritat i fik ndër kthina,
kujtimet e ditës i vjedh.

HANA

Si dhelpna n'kurth ndër re asht zanun hana
dhe nis ngadalë m'u tretë;
ndër andrra t'kandshme koten bjeshkët përana
e n'heshtje bien me fjetë.

DHE LOTI

Kopshtijeve t'blerata qetas lodron puhia -
ajo n'dritare pret:
ja puth qepallat një gjum' i andrrave t'kqia
dhe loti n'mjekërr zbret. . .

SHKALLA NË LIS

Un n'mriz me dele isha
kur bana n'lis kët shkallë
e 'i mall i mshefun m'tha:
Kujtim le t'jetë ndër stinë.

Dhe n'maje t'bjeshkës e lash'
që t'vij kur t'mbushem mall
të mrizi i hershëm n'rrah,
n'kujtim ta gjej fmininë.

Por sytë më mbushen lot
kur shkallën n'lis e shof
si goja me dhambë ra,
të mbushun plot me rrshinë

Dhe m'duket sikur m'thotë:
— Djalosh, un' ty s'po t'njof,
pse moti nuk t'kam pa
e koha gjithshka fshin!..

V J E S H T Ë

S'jehojnë malet prej barijsh;
N'hije t'heshtjes n'gjum kanë ra.
Kurrkund natën dritë as pishë;
Za as njeri n'tëbana s'ka.

Po i ka lodhë e i ka k'putë vjeshta,
si kur pleqt' ndoj udhe kthehen;
tunden drujt' kërcu ndër kreshta
si luftarë që n'prita s'kthehen.

S'duken nuset nëpër shtrunga,
kurrku fyell nuk ndihet ditën;
tash as plakat s'tjerrin shllunga
ndër shullaje as nuk rreziten.

Dënesin degzat — pikon fleta
gjethit t'malit që a' zbe:
shqim gjelbërimt ja k'put jeta
der' t'qet synin stina e re.

RËNKIMI I VORREVE

Thuej, nanë,
a u gëzove shumë në jetë
tri herë
tri drita kur linde,
tri kokrra krypë në sy?

A u gëzove shumë
tri gëzime kur linde,
tri gjurma tretun rrugësh?

Thuej, loke,
a u gëzove shumë
kur linde
tri shtylla t'jetës,
tri shpresa t'ngrohta t'ardhmënis' sate,
tri bulza t'thame motit?

A u gëzove në jetë
tri herë,
kur linde tre fëmij't e tu,
tre ujqit e tu,
tre gurë të zez të malit?

N A N Ě S

Sisën prej goje ma hoqe, nanë, pa u ngi
e m'le tue qa,
dhe sikur të vdissha s'më dhe ma të pi,
as s'erdhe me m'pa.

I mitun, nanë, isha, lotët si shi
nuk pat kush t'm'i ndalë.
«Ndër dajë t'ka shkue nana — m'than' — dert
mos ki,
e prap' ka me t'ardhë».

Dhe n'andrra t'jetës mbeta tue u përkundë
n'mjerime
me njimijë shpresa, se një ditë kam m'u ulë
n'prehët t'lokes sime.

Por... prehnin tand, nanë, gjithmonë mall e
pata

e motet, ndër vedi po ndrrohen;
andrrat e mia, nanë, qenkan andrra t'gjata,
dhe qe — rrudhat e ballit do m'shtohen.

O K A N G Ë

Nëpër çdo vend,
fushat gjezdis me jehun tand
e zemrat i rrit kështjellë,
rrugët e jetës me shpresa i shtron n'çdo kand,
lumni tue ndjellë,

dhe thërret gazmend,
me dallgën tande malet i puth
e bjeshkë e vrri,
lotit buzëqeshjen ja fal e n'ara puntorit
hovin ja kall n'gji;

ndër çaste t'vështira
vuejtjet vërshon me vrull që ke,
brenç' e halle tue korrë,
me himnin tand epshtet dhe gjakun e nxe'
e këndell ti kambë e dorë!

Për ditë ma t'mira
me dallgë përdridhu përballë shtrëgate,
heshtjen e shpo si shgjeta!
Shungllo gjithherë! E prij për gëzime e fate
se sk'terrë pa ty m'asht jeta!

LIRIKË INTIME

Dëshirat e mia
dëshira kasolle janë,
se n'zemër t'ftoftë t'nji nate t'netve tona
n'kasolle t'ty mosun kanë lindë
e n'natën e verbueme kan' klithë,
tue bredhë nëpër anrrat e derdhuna
të fëminisë sime të njomë
si qumshti.

Në kasollen e përmbysun, atje
gëzimi ka lindë një natë
e asht krye pagëzimi,
emnin e lashtë tue përt'ri
t'gjyshit jetik,
dhe nalt' në shkamb ka bi
loti e kanga e maleve.

At' natë
edhe busmat e djeguna kanë qeshë
si buzët e nanës s'përgëzueme
e, n'flakën e tyne t'zbetë,
andrra e dëshira jan' pjekë,
andrra e dëshira janë djegë
si unët e kryqëzueme n'votër.

Atje
me dy fije shprese
nana ka lidhë djalin
dhe me lot e qumësht
mâ' e ka gjithë natën,
tue i gugëzue si zogla
mbi rropamë t'thyeme.

Dëshirat e mia,
dëshira kasolle janë,
por kisha dëshirue
që kudo ndër kasolla,
skutave të kësaj bote,
gjithmonë t'jehojë kanga.

LOTËT E MALEVE

Me buk' e krypë n'dorë
çdo trung e lis kam lutë
për nji pllambë strehë;

bari kam qenë,
Retë mbi mue kanë shti
n'për bjeshkë me hutâ t'ndryshkuna.

Me bukë e krypë n'shpirit
çdo trung e lis kam ftue
në drekën time t'vorfën;

bari kam qenë.
Lotët e maleve çdo ditë i kanë la
faqet e mia.

M'i ktheni lotët e mi,
o male!
m'i ktheni, e për çdo lot
do t'ua këndoj nga 'i kangë!

K È R C È N I M I

Mbramë,
ku thehen krahët e gëzimit
e diell' i jetës tret mbas malit,
hijen tande e pashë
ngadalë kah unë tue u matë;

mbramë,
në cakun e të gjitha caqeve,
ku fjala e kamba ngrihen,
në pëshpëritjen tande tinzake,
heret, shum' heret e ndjeva
emnin e vogël t'kurrkushit
edhe hijen time kah përpëlitej si gjeth i
vramë
e pashë ndër dhamb' t'përgjakun.

Mbramë...

E tash
shpeshherë po e ndiej
shushuritjen e kambëve tua
livadheve t'gjoksit tim,
dhe e di:
— Diku...
Ti po vjen
me hapa të mdhej sa vjeti

PËRRALLA E MSHEFUN

N'at krahnor
stinët kunorë
me gishta t'nji dallge
dy kandila kanë kallë.

Në flakën e tyne
i digjen djalit dëshirat
sa herë krahët e andrrës
ta sjellin n'gji.

Aty,
në një fije shprese
përflaket edhe andrra
që e ruen si gjën' e vjedhun
askush mos ta dijë.

— E kujt asht shpresa,
e kujt asht andrra,
Rrushe, moj,
kuj' do t'ja thuesh at'prallë?

KËPUTE NJI LULE

Stina e luleve erdh e n'kopshtin e andrrave tua
që kamb' as hije s'e shkeli,
epshet i njomi gjelbërimi shqim tue shtrua
e lule t'reja çeli.

Dhe qe, si t'djeg dëshira
kah rreth ndoj lule bredh
që msheftas syni zgjedh
e kapet ku a' ma e mira.

Këpute një lule, vashë, këpute ku t'thot lakmia
se stinëve u ndeje mjaft n'besë,
këpute! Se edhe në s'e kpute, kur t'prendojë rinia
nuk ka me t'lypun ndjesë. —

pse ende gjithherë stinët
e lule sjell pranvera,
po n'ne, dikur, lum vasha,
do t'çelin lule tjera...

Q O R T I M.

Qeshu njiherë!
Ta shof n'at rreze syni
dritën që andrrat i ngjall.

Qeshu!
Ta shof n'at rreze drite
shendin që shpresat m'i kall!

Mos e ul vetullën,
andrrave t'lashta kunorë
faljau edhe sonte — dhanti.

Mos!..
Se qiell' i dëshirave tona
vrahet e do t'rigojë shi...

KUR TË SHKOSH

Kur të shkosh
lema një fjalë,
agimeve t'vetmueme t'ua falë
ma t'bukurin kujtim;

kur të shkosh
lema shikimin pikllues
që të shof edhe kur je larg;

kur të shkosh
lemi kujtimet
që t'luej me to si foshnja.

P Ë S H P Ë R I T J E

Sa herë malli
pik në zemër —
ajo hesht
me 'i emën n'buzë;

sa herë dallga
thehet n'krahnor —
ajo zgjohet
me 'i emën n'buzë.

D A S H N I

T'i kisha duert e majeve,
sonte do ta sillsha
kunorën e yjve n'prehën;

t'i kisha krah't e erës,
sonte kisha me e thye pullazin e andrrave
edhe pse, ndoshta,
as lotët e reve s'kishin m'e la
mëkatën e dëshirave t'marra.

Por
vetëm Ti m'i fal
duert e majave,
krahët e erës
dhe mëkatet e dëshirave t'mia t'marra.

D Ě S H I R Ě

Dëshiroj sonte
të jem kangë
e dallgës sate,
n'ty me u shkri;

dëshiroj sonte,
kur t'derdhet nata,
të jem yll
n'dritaren tande;

dëshiroj sonte,
kur bota flen,
të jem gjum'
n'andrra me t'përkundë;

dëshiroj nesër,
kur t'lind' agimi,
të jem dëshirë
dhe t'kallem flakë në ty.

K U S H T I M I

Toka jonë e mirë, toka jonë e pagojë
do ta shtrydhë fjalën derisa gjak t'pikojë.

Të të flas nga gjaku, pastaj fjalës sime
t'i vijë erë e gurit, erë e farës së mbime.

Thepohem me ty mbi valët e çdo shtërgate
t'bëhem një grusht dhe i mirë i arës sate.

K U R O R A

Cili poet tha se ti je gjaku ynë?
Emrin tënd ua kemi ngjitur vashave më të bukura.
Cila nënë nuk i paloi duart në parzëm për ty?
Emrin tënd ua kemi ngjitur vashave më të bukura.
Cila fjalë s'vdes n'buzë, cila dashuri është më e
rënda?
Emrin tënd ua kemi ngjitur vashave më të bukura.
Cili vocrrak s'do t'i ketë sytë dhe buzëqeshjen
tënde?
Emrin tënd ua kemi ngjitur vashave më të bukura.
O, cila etje m'i kërkon kështu krojet e gjakut?
Emrin tënd ua kemi ngjitur vashave më të bukura.

SHTEGTARËT E VARGUT

Një ditë, kur ta pimë gjithë verën e fjalëve tona,
nga mençuria të mbetemi t'fyshkët si shpuzë,
na çojnë ndër vorre të t'urtët. A thua tevona
këtë pije tonën do ta vënë më n'buzë?

Apo vetëvetes dritë i kemi bërë vetë
me këtë flakë mitare, gjakun e kemi nxe
dhe kështu t'magjepsur kemi mbërri më shpejt
deri n'fund t'jetës, apo kurrë s'kemi le?

KATËR KËSHILLA VETES

Mos u bëj poet nëse s'mund të lindësh
me secilin varg, të lindësh me secilën fjalë;

ngreu mbi veten në do t'rrokësh frerët e erërave,
të shkelësh shpërgajt' e mërisë dhe shtërgatat e
gjakut tënd;

n'se dashurohesh, dashurohu n'flakë e n'valë,
jo në sy të kaltër, se bëhesh det i çmendur
pendimi;

mos u bëj poet nëse s'mund të vdesësh
për secilin varg, të vdesësh për secilën fjalë.

M U Z G U

Mbi supe t'lodhur muzgu pikon dhe.
Iku edhe kjo ditë si gruaja e lëshuar.
Natë e shkëlqyer për një dhembje t're
më thotë tinëzisht një parandjenjë e truar

dhe m'qaset ngadalë, ndërsa i numroj si gjëmë
hapat e mi, që sontë s'di nga m'çojnë.
N'kët qytet t'bukur vetëm jam: një nëmë
e pritjes së vonë që rrugët e mashtrojnë.

Iku edhe kjo ditë. Ja se si rrëzohet
beden i fundit i një krenie t'marrë.
Unë i them vetes hidhur diçka që s'thuhet
dhe thek hapin tim t'mos hiqet zvarë.

NATA NË KËSHTJELLË

I mbрами peshkatar në ditën e bjerrur n'rrjetë
po kthehet. Unë eci duke prekur nëpër mur.
Pas zërit të heshtjes zvarem ngadalë përpjetë;
hapin gur e kam; edhe zemrën, gur.

Ja, tani kështjellës i kam hypë përmbi.
Vonë është, terr. Nata, disi lëmekur,
merr frymë n'për vrimat që mezi shihen zi
dhe ankhëm m'kundrojnë si sytë e prindit
t'vdekur.

Mejtuar si fëmija i shkruaj do emra n'rrasë.
E m'duket dashurisë sonë ja fala një grimë
amshim.

Por gjerbë e rigës s'motit gurin do ta plasë
t'parën pranverë, duke tallë mashtrimin tim.

Prandaj me dorë, trishtueshëm, pak nga pak
faqen e shkëmbit fërkoj si vashën. Dua të fshi
at' marri t'vogël. Vesë? Jo, por gjak
i vokët kullon nëpër gishta t'mi.

Harroj përse e si e nga kam ardhë,
harroj të flas, të lëviz; harroj pa parë
e ndër gjermadha bëhem një copë gjermadhë,
një gur mbi gur që gurit s'don të ndarë.

PARA ELEGJISË

Një ditë do t'i marrësh në gji gjethet e rëna të stinëve
tua
dhe do kërkosh kot veten shtigjeve të harruara të një
moshe
e nuk do të kesh më as flokë ere as shikim ylberi
ta matsh fillin dhe fundin e mashtrimit tënd të
shkurtër;
një ditë do t'i shpalosh vjet' e tua si pajën e nuses
së vdekur
e do të numrosh flutrat e shkruara t'agsholeve
t'per'nduara
e s'do të kesh më as zjarr në buzë as lot në sy
të qeshësh ngrohtë, të qash rrejshëm dhe t'i
mahnitësh djelmoshët;
një ditë do t'i hash buzt'e tua, gjurmt'e tua do t'i
përshtysh
dhe secilin muzg do ta pagëzosh me nga një pendim
që dhemb

e s'do të kesh më as sy deti as hap të hedhur
sorkadhe
të shohësh si t'përqeshin gonxhet dhe të ikësh prej
hijes sate:
Ruaju, moj, se vashat më të bukura i vret bukuria e
vet.

NË VEND TË PËRSHËNETJES

Shko se furishëm po fryn në mua erë mallkimi që
s'të fal. Dhe dije
mirë, kurrë më një e një nuk bëjnë një.
Merri me vete lutjet e tua, edhe hijen tënde, hiqe
zvarë
rrugëve si gjënë e ndyrë. Mos u kthe pas. Mos i
harro
sytë e përlotur në shtekballin tim. Mos thuaj
lamtumirë.
Asgjë mos thuaj. Merri me vete gjurmat nëpër të
cilat
erdhe një natë më e përvuajtur se frika dhe hyre në
mua. Shko.
dhe bëhu fjalë e mbrame n'gojën time. Bëhu
shkrepëtitirë e fikur
n'ylderin e shikimit tim. Bëhu çdo gjë pos Meje e
Teje
dhe asaj që e quajtëm Ne kur i zinin yjët si fluturat

e ua ngjisnim nga një emër mos ta harrojmë emrin
 tonë. Shko
 merri me vete edhe rrugët të mos kthehesh kurrë
 në vesën e lotit të rrejshëm gërmadhat e kujtimit
 t'i rrëzosh. Shko
 mbyllu në do kështjella të largëta harrimi ku s'të
 zgjojnë më
 kumbonat e pendimit kur çmendet mallit vetmia ose
 kur buza buzën
 e han n'pikllim që mëkatin s'e lan, që s'mundet ta
 shpojë
 gurin e rëndë, gurin e ftohtë të ndarjes. Shko, më
 mirë
 dhe hesht. Mos u kthe pas. Mos i harro
 sytë e përlotur n'shtekballin tim. Mos thuaj
 lantumirë
 e kur t'shkojsh larg, më larg se kjre blerimi n'blerim
 e kur t'shkojsh larg, më larg se prej zemre në zemër
 aq larg sa ta narrosh edhe emrin tënd dhe zërin tim,
 fshiu prej vetes,
 shkurto flokëgjatat, mate me to mendjeshkurtrën
 tënde dhe mos qaj. Shko
 se tmershëm po lodrojnë sonte n'mua rrëketë e
 gjakut të ndezur..

ME MIGJENIN

E ngre grushtin Tënd të fortë për t'i ra
skeletit të kuq të vjeshtës si jehona
dhe secilën herë e thyej, — e kam pā,
nga një degë të vrrarë t'stinëve tona;

e ngre grushtin Tënd t'fortë për t'i ra
skeletit të lodhur të vjeshtës si cingëruar
dhe secilën herë më bie mbi ballin kala
nga një gur i dëshirës së rrëzuar;

e ngre grushtin Tënd t'fortë për ta thyer
skeletin e sëmurë t'vjeshtës varë mbi ne
e kreshta,
por fryma e fjala pezmit më lidhen nyje.
Dikush po qan. Dhembja apo vjeshta?

REZIGNATA

Ndjenjë e marrë, që stepeve t'ëndjes m'endesh,
ti frymë as flatra s'do t'kesh për lartësi,
e dhunuar heshtjes n'qenjen time do t'çmendesh,
flamur i grisur pa gjak e pa lavdi.

Dhe sipër teje rëndë do t'shkelin motet
(ato kështu moti lozin edhe me mua),
pse mbas një sqote, që ndër orë t'liga s'kotet,
fat' i marrë heret na mori n'thua...

N Ë N A T

Tim shoku për nënën

Ato lahen në gazin
tonë e në lotët e tyre;

bëhen rojë murane
te krojet e shterra të gjirit.

Në ballin tonë përherë
u bëjnë dritë shejte gishtat.

Ditët na i prarojnë dhe rrugët
me nga një bekim më t'mirin;

një ditë shkojnë, si të shkonin
të mos vijë më vdekja

e s'na kërkajnë asgjë
pos një grusht dhe mbi krye.

Shkojnë. E sa herë vdes nënë,
vdes nënëmira ime.

AKORDE TË THYERA

Ulë si mbi vórr tëndin, rri shpesh duke pritë
at' çast t'vetimshëm t'hireve të zgjuara;
poet, hajt, thuaje ndoj fjalë që t'bën dritë
tërthoreve t'zymta t'ëndrrave t'dhunuara

dhe n'kushtrim t'vargut kalle njëherë gjakun.
Kundërmim' i tij le t'ndihet nëpër fjalë!
N'at kumbim kënge, orët e moshës tiktakun
le ta ngrehin, të mos ketë të ndalë.

VARGJE PËRKUJTIMI

Kur u puthën tytat-dëshirat të lahen në gjak,
ju, puthët moll'zat
e nanave t'molisuna, shokë.
Kur shkrepim agimi, jeta e shpresa u ngjallën,
ngrehët shtëpija të reja
e fleni n'trimen tokë.

Nëpër mjegull kohe e stuhi motesh t'tërbueme,
ditën e natën,
m'teh t'acarit me borë,
netët e malet trupet pa ndalë kurr' hapin
me trimni n'gjoks
e t'ftoftë metalin n'dorë.

Ne, zemrat tueja n'krahnor na rrahin.
Ndienie sot dallgën,
— jueja asht kanga jonë.
Ju s'keni vdekë: me ne jetoni —
me ne!
— Ndër breza u përmendshi gjithmonë!

CKA MËSOVA UNË

Këngë gegërishte

Me u ra tërthoreve trup,
me ndie andjet tue lehë,
me rra mbas xixave n'pup,
me u ndejtë dhimbjeve n'teh,
me shkelë prajshëm n'për tokë,
n'venë t'fjalëve mos me u deh,
me i ndeqë muret me kokë,
me thanë: «fat kobi ku je!»,
mos me dashtë ngushllim,
me folë pa halë me mikun,
m'u varë n'çengelin tim,
me ndezë kandila t'fikun,
me i venë vetimët në sy,
me matë me dorë në zemër,
me gjerbë e mos me pështy,

me prekë Akilin n'themër,
ndër sqota mos me u mekë,
me qeshë pelim me vuejtë,
me dashtë si me vdekë dhe
me vdekë si me luejtë.

N J E R Ë Z I T

Sikur të takoheshim me vetëveten sy më sy,
do t'putheshim apo kishim për t'u pështy?

R R Ë F I M

E di një njeri që ndërton kështjella me fjalë,
ëndërrat ja njoh dhe gjakun e poret ja di;
droj se një ditë erërat shpirtin plot halë
kanë për t'ja shkundur; ai mbetet vetëm puhi.

Duke përpushur me gishta hirin e vet
të dritës së rrjeshme ta gjejë një shkëndi',
vijinë njerëz të mirë, ofshajnë e thonë: Medet,
ky ndërtonte kështjella me fjalë. Lavdi!

M O R T J A

Endet nëpër ne dhe na krijon në çdo pore
varre, të cilat shemben, ose përmendore.

Porse mbi dhunë të saj ne kemi një dhanti:
Ajo di t'marrë, ne — edhe t'krijojmë njeri.

IDHUJ TË RREJSHËM

Tevona fjalës dhe gjakut tim u tëhuaja.
Zura të ngjitem një lartësie t'rrëzuar:
Ju shoh se si të ndyrë ndër ëndjet tuaja
ngroheni në hire t'një drite t'mjeruar.

E n'preftim t'saj secilit i dridhet hia
kah yllin e vet don ta vari mbi tjerë,
por me që toka poshtë e lart lakmia
mbeteni zvarë, statua t'ngrehura n'erë.

gogolë t'urtë, nga të ciltë vijnë e tremben
zogjt' e mëtimit, hie: njerëz as vegla.
Kështu njëra pas tjetrës dalëngadalë shemben
madhështitë tuaja, përzihen me thnegla.

Ndaj, idhuj t'rrejshëm, zbritni nga koka ime,
mbi t'cilën sa kohë ju mbajta si profetën,
më leni t'pëlças prej gazit e prej dhimbe,
ta bëj timen unë — e djalli t'veten.

IN MEMORIAM

Edhe sot mejtova mbi fatkobin tënd
e t'pashë — një valëz e thyer n'teh shkëmbinjsh,
e t'pashë — një valëz e thyer n'teh shkëmbishnjsh,
një namë, një fëmi' i pamëtuat që lindi gand
dhe mbeti n'rrugë.

Shituar orësh së liga, gjithë fuqia t'treti,
gërshërët e motit t'zunë e mirë t'kanë l'nur,
duke bredhë as trohëzash, shite thon e lëkurë,
dikur e bëre piano edhe at'farë skeleti
shëmtimesh vrugë

E bëre piano. Dhe u dehe duke i rënë n'gazmende
t'huaja. Ku t'ftuan e s'të ftuan fill shkove,
sa midis lavdërimesh, brengat i harrove
dhe këso lumërie t'mjerë, një ditë u çmende,
t'muar mendja malë.

Dikush nga daliga, kinse për ta la
me 'i grimë mëshirimi at' mundim t'skamnorit,
e ngriti dorën t'ledhatojë krahërorit:
Ti, fikur mrekullie re, s'u zgjove më.
Vdes dalëngadalë.

KANGA NË REKTIM

(motiv algerian)

...Te votra qe sa net
më pret e kotet nana...

Liri, eja!
Me fjalën tande, buzës ndryshkun t'ja heq
akuajt e zemrës, t'i shkrij' me hymnin e saj!

Liri, eja!
Agimit dritën falmja e diellit — ngjyrën e gjakut,
ngjyrën e krojeve të tua!

Liri, eja!
Tash, që edhe zemra krahnorin po ma shtyn si dem

e n'midis t'logut don me t'dalë përpara,
se sot me plumba shtëpinë për ty e gdhenda
n'rrasë t'krahnorit!.

Eja, liri!

Toka e përgjakun të pret,
se dikur ke me ardhë,
pse n'për shekuj edhe rrugët ecin.

Marrë nga librat: «Bulëzat» (1961), «Engjujt e rrugëve» (1963)
dhe «E di një fjalë prej guri» (1969)

PASQYRA E LËNËS

	Faqe
Ballada në gur	3
Lule gjaku	5
Kanga mbi muranë	8
Përshëndetja	9
Krenaria	10
Takimi	11
Malësorja	13
Kangë arkaike	13
Kanga e kuqe	17
Në buzë të rektimit	18
Uragani	21
Ditiramb	23
Dallga	24
Margarita	26
Në rrugë	28
Poemë e pakryeme	30
Vallja e shkrepave	31
Gryka	33
Hajla	35
Kostarët	38
Lakmia,	40
Rrëfimi i gjyshes	41
Malli	43

	Faqe
Kallximi në tri kangë	45
Akuarele.	47
Shkalla në lis	49
Vjeshtë	50
Rrënkimi i vorreve	51
Nanës	53
O kangë	55
Lirikë intime	57
Lotët e maleve	59
Kërcënimi	61
Përralla e mshefun	63
Këpute një lule	64
Qortim	65
Kur të shkosh	66
Përshpëritje	67
Dashni	68
Dëshirë	69
Kushtimi	70
Kurora	71
Shtegtarët e vargut	72
Katër këshilla vetes	73
Muzgu	74
Nata në kështjellë	75
Para elegjisë	77
Në vend të përshëndetjes	79
Me Migjenin	81
Rezignata	82
Nënat	83
Akorde të thyera	85
Vargje përkujtimi	86
Çka mësova unë	87
Njerëzit	89

	Faqe
Rrëfim	90
Mortja	91
Idhuj të rrejshëm	92
In memoriam	94
Kanga në rektim	96